



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS**  
**AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU**  
**KOSOVO COMPETITION AUTHORITY**

Prishtinë, me 10 Prill 2020  
Nr. Ref. 28/20

Në mbështetje të KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS neni 10 dhe neni 119 pika 1 dhe 3, si dhe të nenit 28 paragrafi 1 pika 1.7 pika 1.8 pika 1.10 të LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS si dhe LIGJIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-229 PËR MBROJTJËN E KONKURENCËS Nr. 04/L-226, **KOMISIONI I AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURENCËS** i përbërë nga: Valon Prestreshi - **Kryetar**, Ahmet Krasniqi - **Zv. Kryetar**, Fatime Haziri – **Komisionere**, Muhamet Krasniqi – **Komisioner**, Shaqir Morina – **Komisioner**, në mbledhjen e mbajtur me datën **10 Prill 2020** sjell këtë:

### REKOMANDIM

- I. **AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS (tutje ref. AUTORITETI) vlerëson** se Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 02.04.2020 nr. 05/21 dobëson presionin konkurrues i cili shpie në përforcimin e kompanisë ekzistuese.
- II. **AUTORITETI konsideron** se Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 02.04.2020 nr. 05/21 mund të shpie tek format e keqpërdorimit të pozitës dominuese nga Telekom i Kosovës.
- III. **AUTORITETI vlerëson** se Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 02.04.2020 nr. 05/21 **është në kundërshtim** me ekonominë e tregut me konkurrencës të lirë.
- IV. **AUTORITETI sygjeron** Qeverinë e Republikës së Kosovës që ta rishikojë vendimin datës 02.04.2020 nr. 05/21.

### ARSYETIM

- Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 02.04.2020 nr. 05/21 me të cilën përjashton Ligjin e Prokurimit Publik për shërbimet telekomunikuese që ofron Telekom i Kosoves, si shërbime me rëndësi të veçanta shtetërore, mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës përkatësisht neni 119 pika 3 citoj “*Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.*”

- Me këtë vendim Qeveria e Kosovës i ka përjashtuar në tërësi ofertat që mund t'i ofrojnë ndërmarrjet për shërbime telekomunikuese, duke i përjashtuar procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik, dhe duke e bërë monopol natyror, "Telekomin e Kosovës"
- Sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 10: Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Si e tillë institucionet e shtetit e posaçërisht Qeveria e Kosovës dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, është i obliguar ta zbatojë këtë dispozitë kushtetuese dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- Integrimi i Kosovës në BE dhe standardet që dalin nga Rregulloret e Komisionit Evropian (Neni 101 i TFEU-së) që kërkohen të arrihen në këtë proces është një tjetër faktor përcaktues dhe nxitës për fushën e konkurrencës. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, neni 74 dhe 75, shërbejnë si një katalizator për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të konkurrencës në përputhje me standardet dhe praktikat evropiane.
- Një mjedis konkurrues siguron se do të ketë hyrës potencial në "garë" për të prodhuar një produkt të ri apo për të ofruar një shërbim më të mirë. Si pasojë, konkurrenca e fuqishme përbën nxitësin kryesorë të rritjes së produktivitetit dhe siguron që tregu do të mbetet konkurrues. Nga një mjedis konkurrues i mirëfilltë jep mundësi të zgjedhjes, shërbime më të mira, cilësi, çmimet konkurruese dhe produktet të reja (inovacione).
- Aktet normative duhet t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet në treg. Evitimi i favorizimit dhe krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet e mëdha mundëson krijimit të ndërmarrjeve që zotërojnë fuqi tregu dhe pengon ndërmarrjet e tjera të jenë konkurruese në treg, e posaçërisht ato ndërmarrje që janë në të njëjtin nivel të operimit dhe ofrimit të shërbimeve.
- Për më shumë, organet shtetërore në të gjitha nivelet në vend të njoftohen se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i obliguar sipas ligjit, që të jetë aktiv për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet nëse këto veprime kanë efekte në treg.
- Se çfarë u tha më lartë, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës vendosi si në dispozitivë të këtij rekomandimi.

## KOMISIONI AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS

  
 (\_\_\_\_\_) Valon PRESTRESHI  
 Kryetar



  
 (\_\_\_\_\_) Ahmet KRASNIQI  
 Zv. Kryetar

  
 (\_\_\_\_\_) Fatime HAZIRI  
 Komisionere

  
 (\_\_\_\_\_) Muhamed KRASNIQI  
 Komisioner

  
 (\_\_\_\_\_) Shaqir MORINA  
 Komisioner

**Me këtë rekomandim, të njoftohet:**

- *Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës – zonja Vjosa OSMANI*
- *Kryeministri në detyrë – z. Albin KURTI*
- *Kryetari të Komisionit parlamentar për Ekonomi, punësim, tregt, industri, ndërmarrësi dhe investime strategjike – z. Endrit SHALA*
- *Arhivës*